



**Ambasciata d'Italia
Pristina**

**DOKUMENTET E NEVOJSHME PER
HEQJEN E NDALESSES SE HYRJES NE TERRITORIN KOMBETAR
KERKESE E VECANTE PER BASHKIM FAMILJAR
ME NENSHTETAS JO - TE BASHKIMIT EUROPIAN**

I nderuar aplikues,

Në bazë të Qarkores së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Italisë n. 1575 të datës 04.04.2008, Ju informojmë që procedurat për heqjen e ndalesës së hyrjes me qëllim Bashkimin Familjar me nënshtetas jo-të Bashkimit Europian janë si më poshtë vijon:

Dokumentet e nevojshme:

- **kërkesa e veçantë për heqjen e ndalesës – modeli i kërkesës plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumenteve përkatëse dhe nënshkruhet në prani të zyrtarit përgjegjës të Ambasadës;**
- **konfirmimi zyrtar nga Sporteli Unik për Emigracionin (Sportello Unico per l'Immigrazione) kompetent;**
- **fotokopje e qartë e Lejes së Qëndrimit (permesso di soggiorno) të aplikuesit në Itali;**
- **dokumentet e gjendjes civile që dëshmojnë lidhjen familjare me personin me vendbanim në Itali me të cilin bëhet Bashkimi Familjar;**

-nëse bashkimi familjar bëhet me bashkëshortin/en me banim në Itali:

certifikata e martesës, e lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

-nëse bashkimi familjar bëhet me babain/nënëen me banim në Itali:

certifikata/t e lindjes e/së fëmijës/ve, e/të lëshuar/a nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e/të legalizuar/a nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

-nëse bashkimi familjar bëhet me djalit/vajzën me banim në Itali:

certifikata e lindjes e djalit/vajzës me banim në Itali, të lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

- **Vërtetim, i lëshuar nga Gjykata e Qarkut kompetente, ku të vërtetohet që aplikuesi nuk ka iniciuar procedurën e shkurorëzimit (në rast Bashkimi Familjar me bashkëshortin/bashkëshorten);**
- **fotokopje e një letërnjoftimi valid;**



**Ambasciata d'Italia
Pristina**

KUJDES: Ambasada nuk ka të drejtë hyrjeje në të dhënat Tuaja personale, Ju mund të ushtroni të drejtën Tuaj për verifikimin, ndryshimin apo fshirjen e të dhënave Tuaja të pranishme në Sistemin e Informimit Schengen duke iu drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Italisë, Departamenti i Sigurisë Publike, Zyra e Koordinimit dhe e Planifikimit të Forcave të Policisë, Seksioni N.S.I.S. që gjendet në këtë adresë:

**Ministero dell'Interno
Dipartimento Pubblica Sicurezza
Ufficio Coordinamento e pianificazione delle forze di polizia
Divisione N.S.I.S.
Polo Anagnina, Palazzina B
Via di Torre di Mezzavia, n.9
00173, ROMA
ITALIA**

KUJDES: pas pranimit të dokumentacionit përkatës, zyrtari i Ambasadës Italiane, përgjegjës mbi procedurën administrative, pas verifikimit të përmbushjes së dispozitave ligjore në fuqi, do të lëshojë një vërtetim mbi hapjen e procedurës administrative përkatëse nëpërmjet së cilës Ju do të informoheni mbi detajet e saj.

AMBASADA ITALIANE NE PRISHTINE